



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2018

### V E N D I M

#### Nr. 226, Datë 06 / 11 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.94 Regj., datë 25.06.2018, të z.A. Y, kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë (DRSSH Korçë), me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës” dhe të “aftësisë së kufizuar”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I :

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Z.A. Y, në ankesën e sjellë pranë KMD-së shprehet se, nga ana e Komisionit të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) Korçë i është dhënë statusi “Invalid i plotë, Grupi II-të” dhe është trajtuar me pagesë paaftësie (kemp), në masën 13 342 lekë. Kjo pagesë ka vijuar nga viti 2014 deri në vitin 2017, pasi nga ky vit e në vijim, megjithëse vazhdon të trajtohet sërish me të njëjtin status, paguhet në masën 8 132 lekë. Z.A. Y shprehet se është ankuar pranë Komisionit të Caktimit të Aftësisë për Punë Epror (KMCAP Epror) por nuk i kanë dhënë shpjegime se përse atij i është ulur masa e pagesës. Ai ka depozituar në cilësi prove dy vendime të KMCAP Korçë, respektivisht: Vendim nr.1106, datë 02.05.2017 dhe Vendim nr.603, datë 06.03.2018.

Subjekti ankues kërkon të përfitojë pagesën e paaftësisë në masën e mëparëshme (prej 13.342 lekësh).

#### **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen

*shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së<sup>1</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale<sup>2</sup>, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën me nr.911/1 prot., datë 26.06.2018 i është kërkuar informacion ISSH Tiranë dhe DRSSH Korçë, lidhur me pretendimin e z.A. Y<sup>3</sup>.

Me shkresën me nr.4190/4 prot., datë 02.07.2018 DRSSH Korçë ka informuar Komisionerin se:

*“...Në zbatim të Vendimit nr.1148, datë 09.04.2014 të KMCAP Korçë, DRSSH Korçë, me Vendimin për Caktim Pensioni nr.1149, datë 15.05.2014 i ka caktuar z.A. Y pension invaliditeti në masën 11.721 lekë, duke i llogaritur 16 vjet e 6 muaj vjetërsi pune gjithsej. Në zbatim të VKM-ve përkatëse<sup>4</sup> për kompensim të ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike, të çmimit të bukës, vajgurit e gazit të lëngshëm, z.A. Y përfitonte edhe 1.621 lekë në muaj, duke i vajtur gjithsej shuma e përfitimit në vlerën 13. 342 lekë në muaj. Pensionin e invaliditetit e ka përfituar në këtë*

<sup>1</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

<sup>2</sup> Nga pikëpamja formale, ankesa është plotësuar me dokumentacion nga ankuesja me datë 01.08.2018, referuar shkresës me nr.3573 prot., datë 01.08.2018.

<sup>3</sup> Kopje të dosjes së z.A. Y.

Informacion nëse ka persona të tjerë në kushtet e z.A. Y<sup>3</sup>, që përfitojnë pagesë paafësie për punë, për periudhën 2017-2018. Informacion mbi arsyet e uljes të pagesës së paafësisë për punë nga ana e DRSSH-së Korçë dhe ISSH-së Tiranë.

Informacion nëse z.A. Y është ankuar pranë institucioneve tuaja. Nëse po, cilat janë masat e marra prej Jush? Një kopje e praktikës së mbajtur.

Si dhe çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

<sup>4</sup> VKM nr.763, datë 27.11.2006, VKM nr.415, datë 30.04.2009, VKM nr.474, datë 30.06.2010.

*masë deri me datën 31.03.2016 datë kur ai është rikomisionuar. Më pas me Vendimin nr.1226, datë 17.05.2016 të KMCAP Korçë është caktuar “pa grup” nisur që nga data 01.04.2016. Me Vendimin nr.477, datë 19.09.2016 të KMCAP Epror është vendosur “pa invaliditet, i aftë për punë të lehtë”. Në zbatim të këtij vendimi, DRSSH Korçë me Vendim për mbyllje pensioni nr.1149/1, datë 30.09.2016 është mbyllur pensioni. Më pas, pas kërkesës së re të ankuesit për caktim pensioni invaliditeti, pas aksidentit në punë, sëmundje profesionale, me Vendimin nr.1106, datë 02.05.2017 të KMCAP-së, DRSSH Korçë ka caktuar se ka humbur aftësinë për punë në masë të plotë prej datës 21.04.2017-31.03.2018 me “diagnozë” të re. Në zbatim të këtij vendimi me Vendim për caktim pensioni nr.1377, datë 08.05.2017 është caktuar pensioni duke llogaritur 17 vjet e 4 muaj vjetërsi pune gjithsej dhe masën fillestare të pensionit 8.132 lekë në muaj<sup>5</sup>”.*

Në përgjigjen e tyre, DRSSH Korçë, sqaron Komisionerin se në zbatim të Ligjit nr.7703, datë 02.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa  $\frac{3}{4}$  e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paafte dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës, të ketë të paktën 12 muaj sigurim shoqëror. Në rastin e z.A. Y periudha minimale e sigurimit është 31.35 vjet, ndërkohë periudha e llogaritur e vjetërsisë në punë është 17.4 vjet. (me KFI 21.04.2017).

Me shkresën me nr.5158/2 prot., datë 31.07.2018 ISSH ka sjellë të njëjtat parashtrime me ato të DRSSH Korçë, duke theksuar se ata bëjnë vlerësimin e personave bazuar në gjendjen e tyre shëndetësore dhe referuar dispozitave ligjore përkatëse dhe raca e tyre nuk ka fare lidhje me këtë vlerësim.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së z.Y, Komisioneri me datë 25.09.2018 realizoi një seancë dëgjimore<sup>6</sup>.

Në seancë nuk u paraqitën asnjëra nga palët në proces. DRSSH Korçë përmes një telefonate lajmëroi se për shkak të angazhimeve institucionale nuk e kishin të mundur të paraqiteshin në seancë, dhe se u qëndronin të njëjtave parashtrime që kanë bërë prezent para Komisionerit me anë të shkresës me nr.4190/4 prot., datë 02.07.2018.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm të ankuesit nga DRSSH Korçë.**

<sup>5</sup> Bashkëlidhur janë vendimet respektive të cituara në shkresë.

<sup>6</sup>Në zbatim të Njoftimit me nr.911/4 prot., datë 20.09.2018, të Komisionerit.

Shteti shqiptar ka miratuar një korpus të tërë aktesh ligjore dhe nënligjore, nëpërmjet të cilave rregullon ligjërisht ndihmën dhe shërbimet shoqërore. Pagesa e invaliditetit është një ndër përfitimet që personat me aftësi të kufizuar mund të marrin nga shteti, si bonus, në ndihmë dhe në shërbim të tyre. Në bazë të dispozitave përkatëse, këtë pagesë nuk mund ta përfitojnë të gjithë personat me aftësi të kufizuar, por vetëm invalidët të cilët janë deklaruar të tillë me vendim të KMCAP-së. Më poshtë bëjmë një analizë të legjislacionit përkatës:

Në nenin 35, të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohen shprehimisht kushtet e përfitimit të pensionit të invaliditetit. Dispozita e sipërpërmendur parashikon se:

**“Personi që bëhet i paaftë merr pension invaliditeti, kur ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit dhe për çdo arsye, veç aksidentit në punë ose sëmundjes profesionale. Ai e merr këtë pension kur bëhet i paaftë:**

a) për çdo veprimtari ekonomike;

b) kur ka gjytime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin). Invaliditeti caktohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP). Në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij, si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve Eprorë caktohen me këtë Ligj. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve të nivelit të parë caktohen me Rregulloren të ISSH-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror. Personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti.

...Invaliditeti caktohet nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë (KMCAP). Në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë. **Kundër vendimit të KMCAP-it të rrethit personi mund të ankohet në KMCAP-in Epror pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, vendimi i të cilit përsa i përket caktimit të aftësisë për punë është i formës së prerë.** Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve caktohen me rregulloren të ISSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Referuar parashikimeve të nenit 35, të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohen shprehimisht kushtet e përfitimit të pensionit të invaliditetit dhe rezulton se vendimet e KMCAP Rajonale<sup>7</sup> mund të apelojnë pranë KMCAP Epror, dhe vendimi i këtij të fundit ka formë të prerë për invalidin ose të sëmurin.

<sup>7</sup>Shih pikat 10 dhe 13 të Rregullores së datës 30.05.2005 “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë të Individëve”.

Nga këqyrja e dokumentacionit për z.A. Y, rezulton se KMCAP Korçë me Vendimin nr.1148, datë 09.04.2014, e ka vlerësuar z.Y, invalid të plotë për periudhën 24.04.2014-31.03.2016 me diagnozë “AVC Ishemik Hemiparesis Dexter, Diabet Mellitus Tip 2, Dislipidemi”, me datë fillimi invaliditeti 24.10.2013.

Referuar datëlindjes 24.05.1955 dhe datës së fillimit të inavliditetit 24.10.2013, z.A. Y duhet të kishte periudhë sigurimi 19 vite e 2 muaj. DRSSH Korçë në zbatim të sa më sipër, me Vendimin nr.1149, datë 15.05.2014 i ka caktuar z.A. Y pension invaliditeti me 16 vite e 6 muaj periudhë sigurimi, në masën 11.721 lekë në muaj; përfitim i paguar deri në datën 01.04.2016.

KMCAP Korçë me Vendimin nr.1226, datë 17.05.2016 e ka vlerësuar “pa invaliditet”, vendim të cilin z.Y e ka ankimuar pranë KMCAP Epror. KMCAP Epror, pas shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor e ligjor, si dhe gjendjes shëndetësore të ankuesit, me Vendimin nr.477, datë 19.09.2016 për diagnozën “Gjendje pas AVC ishemik pa defiçite motore” e ka cilësuar atë “Pa invaliditet, prej datës 01.04.2016, të aftë për punë të lehta”. Meqenëse vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë<sup>8</sup>, me Vendimin nr.1149/1, datë 30.09.2016 për mbyllje pensioni, është mbyllur dosja e përfitimit të z.Y.

Ndërkaq, me datë 21.04.2017, z.Y është pajisur me Fletë Drejtimi të re nga Spitali Rajonal Korçë me diagnozë “Infarct cerebral recidivant, hemiparesis dexter”. KMCAP Korçë, me Vendimin nr.1106, datë 02.05.2017 e ka vlerësuar ankuesin me invaliditet të plotë prej datës 21.04.2017 deri me datën 31.03.2019, me datë fillimi invaliditeti (KFI) 21.04.2017. Pra jemi në kushtet e një komisionimi tjetër, me diagnozë të re, dhe KFI (kohë/datë fillimi invaliditeti) të ndryshëm tashmë; për rrjedhojë edhe vlera e pensionit të invaliditetit do të jetë e ndryshme.

Neni 35 i ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore në RSH”, parashikon se, periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa  $\frac{3}{4}$  e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror. Personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti.

Në referim të sa më sipër, DRSSH Korçë, me Vendimin nr.1377, datë 08.05.2017, i ka caktuar të interesuarit pension invaliditeti të reduktuar, me 17 vite e 4 muaj periudhë sigurimi, në masën 8.132 lekë në muaj.

Për të përfituar pension të plotë invaliditeti, sipas përcaktimeve ligjore të sa më sipër, referuar datëlindjes së z.A. Y 24.05.1955 dhe kohës së fillimit të invaliditetit 21.04.2017, ai duhet të kishte periudhë sigurimi 31 vite e 4 muaj, ndërkohë që ka vetëm 17 vite e 4 muaj.

Në referim të legjislacionit të sipërcituar, dhe të kronologjisë së ngjarjeve, subjekti ankues, z.Y nuk mund të përfitojë pension invaliditeti në shumën e mëparëshme siç pretendon ai, pasi

---

<sup>8</sup> Neni 39/1, pika 3 e ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

periudha për të cilën ai ankohet, për të cilën atij i është caktuar pension invaliditeti i reduktuar i përket një disгноze tjetër, e cila ka KFI (kohë fillimi invaliditeti) tjetër dhe për rrjedhojë llogaritja fillon nga kjo datë dhe në masën e përcaktuar nga ligji.

*Në përfundim, mbështetur në ligjin nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se z.A. Y nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e DRSSH Korçë, për shkak të racës apo aftësisë së kufizuar.*

Neni 7 i LMD-së<sup>9</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga ana e DRSSH Korçë lidhur me trajtimin e rastit të z.A. Y.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të z.A. Y nga ana e DRSSH Korçë, për shkak të racës dhe të aftësisë së kufizuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(shkaku: aftësia e kufizuar, raca)

(fusha: të mira dhe shërbime)

---

<sup>9</sup>Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.